



**Australian Government**  
**Department of Health**

**Linja për mbështetje për personat e moshuar për COVID-19**

Me rëndësi është të mbështeten njerëzit e moshuar gjatë koronavirusit. Linja për mbështetje për personat e moshuar për COVID-19 u ndihmon njerëzve të moshuar, të dashurve të tyre dhe kujdestarëve që të qëndrojnë të lidhur dhe të vazhdojnë të pranojnë shërbimet e nevojitura gjatë pandemisë. Linja për mbështetje ofron ndihmë dhe këshillim praktik.

Mund të mësoni për kufizimet në lidhje me koronavirusin, të merrni informacione për shërbimet për mbështetje për kujdesin e të moshuarve apo të bisedoni për shëndetin mental. Njerëzit që shqetësohen për veten, një mik apo anëtar të familjes që jeton me demencë, mund të bisedojnë me këshilluesin e trajnuar të Dementia Australia në linjën për mbështetje.

Linja për mbështetje është e disponueshme për të ndihmuar njerëzit e moshuar, familjarët e tyre, kujdestarët, miqtë dhe mbështetësit. Shërbimi falas përmes telefonit është i hapur nga e hëna deri të premten, përveç festave publike, nga ora 8:30 në mëngjes deri në orën 6 pasdite. Mund të thirrni linjën për mbështetje në **1800 171 866**.

Nëse preferoni të bisedoni në një gjuhë tjetër përveç anglishtes, mund të thirrni një përkthyes. Thirrni Shërbimin për përkthim dhe interpretim në **131 450** dhe kërkoni gjuhën tuaj. Në gjuhën tuaj, mund të thirrni që të lidheni me Linjën për mbështetje për personat e moshuar për COVID-19.

**Skema për vizitorët nga komuniteti**

Skema për vizitorët nga komuniteti u siguron australianëve të moshuar miqësi, shoqërim dhe lidhje sociale. Ai lidh njerëzit me vullnetarët për të kaluar kohën me ata, në bazë të rregullt. Gjatë pandemisë, kjo mund të bëhet përmes telefonit apo videos ku vizitat direkte nuk janë të mundura për shkak të distancimit fizik.

Kontakti i rregullt me vullnetarët mund t'i ndihmon njerëzve të ndjejnë se dikush po i dëgjon dhe kanë mbështetje ata që ndjehen të izoluar apo të vetmuar. Skema për vizitorët nga komuniteti është shërbim falas për njerëzit e moshuar që momentalisht kanë qasje apo janë duke aplikuar për kujdes shëpiak të financuar nga qeveria apo për shtëpi kujdesi.

Njerëzit e moshuar mund të referohen tek Skema për vizitorët nga komuniteti. Referimet gjithashtu mund të vijnë nga ofruesit të shërbimeve për kujdes për të moshuarit, anëtarët e familjeve dhe miqve. Për më shumë, vizitoni [www.health.gov.au/community-visitors-scheme](http://www.health.gov.au/community-visitors-scheme)

## **Mirëqenia mentale**

Koronavirusi do të thotë se ka pasur shumë ndryshime në mënyrën tonë të jetesës. Biseda me familjen dhe miqtë apo mjekun tuaj mund t'ju ndihmon nëse ndjeheni i brengosur, i vetmuar, konfuz apo i frikësuar. Për më shumë informacione, këshillim dhe një varg të gjërë të shërbimeve për mbështetje, vizitoni [www.headtohealth.gov.au](http://www.headtohealth.gov.au)

## **Më shumë informacione**

Me rëndësi është të merrni informacione nga burime zyrtare.

Vizitoni [www.health.gov.au/resources/translated](http://www.health.gov.au/resources/translated) apo thirrni Linjën për ndihmë për koronavirus në **1800 020 080**.

Shkarkoni aplikacionin COVIDSafe për të mbajtur të sigurt familjen, miqtë dhe komunitetin tuaj. Përveç gjuhës angleze, aplikacioni COVIDSafe tani është në dispozicion në gjuhën arabe, gjuhën kineze të thjeshtuar dhe tradicionale, vietnameze, koreane, italiane, greke, punxhabi dhe turke. Aplikacioni mund të shkarkohet nga Apple App store apo nga Google Play store. Mund të kërkoni nga familja apo miqtë apo nga stafi për kujdes të të moshuarve t'ju ndihmojnë për ta shkarkuar aplikacionin.